



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 681 Prot
4

Tiranë, më 12/5/2021

VENDIM

Nr. 26, datë 12.5.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/I të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____ (në vijim "ankuesja") ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim "Komisioneri") ankesën nr. 681 Prot., datë 14.04.2021, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare", kundër Autoritetit Publik/Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 26.03.2021, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. Cili është autoriteti publik që ka paraqitur dosjen për miratimin e Vendimit të Kufijve të Zonave të Mbrojtura pranë KKT-së?
2. Një kopje të përmbledhjes së vërejtjeve apo propozimeve gjatë takimit publik, që i bashkëlidhen projektit të dokumentit të planifikimit, të paraqitur për miratim, referuar nenit 24, pika 4 e ligjit nr. 107/2014;
3. Duke qenë se në përfundim të shqyrtimit, AKPT-ja i përcjell autoritetit përgjegjës përfundimet dhe propozimet përkatëse për trajtimin e mangësive nëse konstaton të tilla. Cili ka qenë qëndrimi i AKTP-së lidhur me propozimin e ardhur nga ana e autoritetit publik kompetent.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 434/1 Prot., datë 08.04.2021, i ka kthyer përgjigje ankueses, duke e informuar ndër të tjera se: "... Bazuar në Ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar, neni 9, shkonja "b" Agjencia

Kombëtare e Rregullimit të Territorit është autoriteti përgjegjës për bashkërendimin horizontal ndërmjet autoriteteve kombëtare të planifikimit gjatë proceseve të planifikimit sektorial apo gjatë proceseve të hartimit të planeve të detajuara për zona me rëndësi kombëtare. Në vijim thekson se kërkesa e paraqitur nuk është në fushën e kompetencave të AKPT dhe dokumentacioni i kërkuar nuk është i prodhuar nga AKPT...".

Ankuesja, pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, pretendon se: *"Autoriteti Publik nuk i është përgjigjur asnjë prej pyetjeve, por ka orientuar për bazën ligjore të procesit. Pretendimi se dokumentat e kërkuara nuk janë hartuar prej tyre, nuk përbën shkak për mosvënien në dispozicion të informacionit. Ligji për të drejtën e informimit ngarkon autoritetet publike, që të vënë në dispozicion të kërkuarve jo vetëm dokumentet që i kanë prodhuar vetë, por dhe dokumentet që i kanë në dispozicion, pavarësisht se nuk i kanë prodhuar vetë".*

Në vijim, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoj se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "LDI").

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: *"Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur"*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 681/1 prot., datë 16.04.2021, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesja, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik, me shkresën nr. 529/01 Prot., datë 26.04.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 681/2 Prot., datë 28.04.2021, ka rikonfirmuar qëndrimin e mbajtur në shkresën e lartpërmendur, duke informuar mbi parashikimet ligjore për trajtimin e kërkesës për informacion të ankueses. Në përfundim thekson se, *AKPT nuk është institucioni kompetent në trajtimin e kërkesës për informacion dhe dokumentacioni i kërkuar nuk është i prodhuar prej saj. AKPT në asnjë moment nuk ka refuzuar t'u përgjigjet kërkesave të znj. Ndreka, por është angazhuar të asistojë maksimalisht qytetaren në identifikimin e autoritetit përgjegjës që ka në dispozicion informacionin e kërkuar.*

Ankuesja, duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Publik, me email-in datë 05.05.2021, ka vijuar ankimin duke sqaruar se: *"... për pikën e parë të kërkesës për informacion kam marrë përgjigje, ndërkohë mbeten të pazezuruara dy pikat e tjera të kërkesës drejtuar AKPT".*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik, sipas të cilave, AKPT nuk është institucioni kompetent në trajtimin e kërkesës për informacion dhe dokumentacioni i kërkuar nuk është i prodhuar prej saj, rezultojnë të pabazuara në ligj.

Në pikën 2, të neni 2 të LDI, parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”,* në këtë kuptim, dokumentet të cilat disponohen nga ana e Autoritetit Publik, pavarësisht nëse janë prodhuar ose jo nga ky i fundit, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në këtë dispozitë duhet të vendosen në dispozicion të kërkuarit në formën e zotëruar.

Ndërkohë në shkronjën a) të pikës 2 të nenit 10, të LDI, parashikohet se: *“Koordinatori për të drejtën e informimit... a) i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentacionin origjinal ose duke marrë një kopje të tij;”.*

Gjithashtu, Autoriteti Publik në bërjen publike të dokumentit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.*

Në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar parashikohet se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 681 Prot., datë 14.04.2021 të znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.*

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas pikës 2 dhe 3 të kërkesës për informacion datë 26.03.2021, konkretisht: (2. Një kopje të përmbledhjes së vërejtjeve apo propozimeve gjatë takimit publik, që i bashkëlidhen projektit të dokumentit të planifikimit, të paraqitur për miratim, referuar nenit 24, pika 4 e ligjit nr. 107/2014; 3. Duke qenë se në përfundim të shqyrtimit, AKPT-ja i përcjell autoritetit përgjegjës përfundimet dhe propozimet përkatëse për trajtimin e mangësive nëse konstaton të tilla. Cili ka qenë qëndrimi i AKTP-së lidhur me propozimin e ardhur nga ana e autoritetit publik kompetent), brenda datës 20.5.2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 12.5.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

